



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 4655/2026
Data: 20.05.2026

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e katër -IV- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.04.2026, me fillim pune në ora 11:00, në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Sevdi Dernjani (Nënkryetar i Komunës), Abduraman Bushi (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Lindita Ballazhi (Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa), Natyra Kalisi (Drejtoreshë e Administratës), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Arbenita Bajramaliu (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), Hisni Luri (Drejtor për Arsim), Abduraman Bushi (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Kimete Kuka-Hasallari (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Senad Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Sevime Bajrami (Kryesuese e Komisionit të Aksionarëve të NPL "Pastrimi" sh.a.), Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2026.
3. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.
4. Informatë për ndarjen e bursave.
5. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2026 i N.P.L. "Pastrimi" sh.a.
6. Bartja e bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026.
7. Kërkesë për futjen e projektit të ri "Blerja e një automjeti zyrtar" në kuadër të buxhetit për vitin fiskal 2026.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: - Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson: - Kemi pasur planifikuar me penguar mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të Komunës për shkak të injorimit që po i bëhet Kuvendit të Komunës. Sot bëhen tre muaj që ekzekutivi nuk na u ka përgjigjur në pyetje, por në momentin e fundit jemi tërhequr prej këtij aktiviteti dhe, prej sotit, të fillojmë me media dhe rrjete sociale të shohim se ndoshta reflektoni ju si ekzekutiv. Unë kam pasur menduar që, pasi jam pjesë e Kuvendit të Komunës, mos me u marrë me rrjetet sociale e me media, dhe ekipës sonë të Aleancës i kam potencuar që mos merrni me shënime, sepse jam në Kuvend dhe atje do ta ngrit debatin për çdo problem që e ka Hani i Elezit, mirëpo po shoh që këtu nuk ka debat. Kryetari me ekzekutivin e kanë bërë Kuvendin, mos të them lodër, e kanë bërë mekanizëm të votimit, mos me hapur debate, por debat bëhet vetëm kur ju konvenon atyre. Mbledhja e kaluar e Kuvendit nuk është transmetuar, por edhe sot nuk po i shoh mediat.

Medina Imishti thekson: - Para se të kalojmë në miratim të rendit të punës, e kam një propozim konkret. Propozoj që të bëhet një ndryshim te rendi i ditës: pika e gjashtë të kalojë në pikën e shtatë dhe pika e shtatë të kalojë në të gjashtën. Arsyeja është se, nëse na e miratojmë bartjen e buxhetit që është planifikuar projekti për blerjen e veturës, më duket që kot pastaj e votojmë futjen e projektit të ri në pikën shtatë, që do të thotë se rrjedha e diskutimit është shumë më e logjikshme.

Kryesuesi thekson: - Drejtorëve ju kam thënë që është mirë me respektuar afatin kohor për çështjen e përgjigjeve. Me sa e di unë, ju kanë dhënë disa përgjigje nga Drejtoria e Urbanizmit, por sigurisht që ka edhe përgjigje tjera që nuk ju kanë dhënë. Sa i përket ndryshimit të pikave të rendit të ditës, mendoj se nuk ka diçka që duhet patjetër me bërë dhe secila pikë e ka rëndësinë e vet. A keni edhe ndonjë diskutim për rendin e punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte 13 për, 3 kundër.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi thekson: - Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin. Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2026

Kryesuesi thekson: - Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson: - Buxheti i Komunës së Hanit të Elezit, i ndarë sipas Ligjit Nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, është në lartësi prej 4,234,682.00 €. Ndërsa, buxheti përfundimtar është 4,340,251.12 €, ku në këtë shumë përfshihen: mjetet e ndara nga grantet qeveritare në shumë prej 3,877,962.00 €, projeksioni i të hyrave vetanake në shumë prej 356,720.00 €, donacioni nga Unioni Evropian për projektin dyvjeçar “A smart system for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej 102,497.64 €, donacion nga Këshilli i Evropës në shumë prej 2,957.80 €, si dhe mjete të mbetura nga grantet, të cilat janë bartur vit pas viti në vlerë prej 113.68 €. Projeksioni i të hyrave vetanake për vitin 2026 është në shumë prej 356,720.00 €, ndërsa realizimi është në shumë prej 24,021.47 €. Në krahasim me vitin 2025 kemi 13,217.65 € më pak se në vitin paraprak. Në këtë tabelë, të hyrat e realizuara për TM1 2026 dhe 2025 janë pa gjokat e trafikut, të gjykatave dhe pa ato të Agjencisë Pyjore të Kosovës. Në tabelën tjetër janë paraqitur të hyrat për secilën drejtori dhe sa ka inkasuar. Shpenzimi i kategorisë buxhetore “Paga dhe Shtesa” për tremujorin e parë të vitit 2026 është në shumë prej 804,948.91 €, apo 32.13% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me vitin 2025, shpenzimi për këtë kategori përgjatë periudhës raportuese të vitit 2026 është më i lartë për 244,257.01 €, apo 43.56% më shumë. Te tabela numër dy, diferenca e të hyrave direkte në shumë prej 1,856.12 € ka të bëjë me kthimin e donacionit të mbetur nga Këshilli i Evropës. Shpenzimi i kategorisë buxhetore “Mallra dhe Shërbime” për tremujorin e parë të vitit 2026 është në shumë prej 52,408.04 €, apo 9.18% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025, shpenzimi për këtë kategori përgjatë tremujorit të vitit 2026 është më i ulët për 44,415.38 €, apo 45.87% më pak. Shpenzimi i kategorisë buxhetore “Shpenzime Komunale” për tremujorin e parë të vitit 2026 është në shumë prej 9,757.67 €, apo 8.79% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025, shpenzimi për këtë kategori përgjatë tremujorit të vitit 2026 është më i ulët për 13,444.36 €, apo 57.94% më pak. Shpenzimi i kategorisë buxhetore “Subvencione dhe Transfere” për tremujorin e parë të vitit 2026 është në shumë prej 25,089.00 €, apo 13.56% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025, shpenzimi për këtë kategori përgjatë tremujorit të vitit 2026 është më i lartë për 24,289.00 €, apo 3036.13% më shumë. Nga kategoria buxhetore “Shpenzime Kapitale”, përgjatë TM1 të viteve 2026 dhe 2025, nuk ka pasur shpenzim. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim, mund të parashtroni.

Medina Imishti thekson: para se me kaluar në përmbajtjen e raportit, e kam një vërejtje, për shkak se raportet financiare po na vijnë me formate të ndryshme dhe besoj që edhe kolegët e kanë pas të vështirë për me parë raportin, dhe kërkoj që herave të tjera formati i raportit me qenë i njëjtë. Sa i përket këtij raporti, shumicën e çështjeve i kemi diskutuar në Komitetin për Politikë e Financa. Në faqe tetë janë paraqitur të hyrat në vlerë prej njëzet e katër mijë euro, ku është dhënë edhe sqarimi që këtu nuk janë përfshirë gjobat nga trafiku, gjykatat dhe agjensioni pyjor, ndërsa në tabelën në faqe dhjetë, saktësisht në kolonat njëzet e tetë dhe njëzet e nëntë, këto të hyra janë të përfshira. Shkrimi nga faqja njëmbëdhjetë deri në faqen njëzet e nëntë mendoj që janë të paarsyeshme dhe nuk besoj që dikush prej kolegëve ka arritur për me i kuptuar, kështu që është një raport që ka mundur me u përmbledhur në dy apo tri faqe. Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve kam disa pyetje, për të cilat kërkoj sqarime. Shërbimet e ndryshme këshillëdhënëse dhe profesionale janë një shumë prej shtatë mijë euro; kërkoj sqarim se çfarë shërbime janë kryer. Po ashtu edhe te shërbimet e tjera kontraktuese, në vlerë prej 2171 €.

Lindita Ballazhi thekson: sa i përket formatit, ndoshta mund të jetë ndonjë gabim teknik, por mundet me u zmadhuar edhe nëpër faqet e tjera për me u vërejtur më mirë se çka përmban raporti. Sa i përket të hyrave, te faqja tetë e raportit të fundit i kemi përfshirë të hyrat indirekte, si për vitin e kaluar, por edhe për këtë vit; ashtu është formati i këtij raporti, por vetëm bëjmë një krahasim me të hyrat direkte, të cilat ne vetë i planifikojmë dhe nuk ka ndonjë gabim te kjo faqe. Te tabela vijuese i kemi në detaje; ky është një raport analitik në faqen nëntë deri në faqen dhjetë. Vitin e kaluar nuk e kemi pranuar raportin për të hyrat indirekte për tremujorin, kanë ardhur pak me vonesë, por në këtë vit, siç e ceka edhe më herët, ditën që e kam përcjell materialin e kuvendit, e kemi pranuar materialin për raportin e të hyrave, kështu që i kam përfshirë në raport që të jetë raporti financiar më i kompletuar. E kuptoj që është raport shumë voluminoz, por ky është raport nga sistemi i menaxhimit të financave publike. Këtë raport e gjenerojmë prej sistemit. Kodet ekonomike “shërbime këshillëdhënëse” dhe “shërbime kontraktuese”, përmes email-it, do t’ua përcjell se çka janë ekzekutuar në këto dy kode ekonomike.

Basri Dernjani thekson: te pagat dhe shtesat kemi rritje diku për 43% dhe besoj që duhet me qenë paga e trembëdhjetë që e ka ngritur këtë përqindje.

Menduh Vlasi thekson: faqe pesë, tabelat i ke shënuar me numra, por në material nuk mundem mi gjet. Në faqe tetë, tabela numër dy, do të ishte mirë që me i paraqitur edhe me përqindje. Në faqe tridhjetë e katër, “shërbime të ndryshme këshillimore” dhe “kompensimi i përfaqësimit brenda vendit”, kërkoj sqarim.

Lindita Ballazhi thekson: te pagat ka të bëjë me pagën e trembëdhjetë, e cila është ekzekutuar nga qeveria e jo nga buxheti ynë. Sa i përket përkufizimeve, këto janë terma, sepse te ky raport nuk kemi as transfere, as alokime, por në raportet në vijim që do t’i kemi, do të jenë pjesë e këtij raporti në raportin gjashtëmujor. Sa i përket faqes tetë, çështjen e përqindjes do ta shënoj edhe përqindjen e të hyrave. Për çështjen e përfaqësimit brenda vendit dhe çështjen këshillëdhënëse, do t’ua përcjell me email si material shtesë se çka është ekzekutuar.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës, hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson: rekomandimi i parë ka të bëjë me çështjen e vonesës në pagesën e faturave dhe shfrytëzime të tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga Thesari. Kjo e gjetur është pjesërisht e zbatuar, sepse shumë lëndë, të cilat ekzekutohen vit për vit nga Thesari, kanë të bëjnë me kontratën kolektive. Ne nuk mundemi t'i kontrollojmë ekzekutimet e të njëjtave dhe as nuk njoftohemi nga Thesari për këto. Kemi dhënë koment në Zyrën Kombëtare të Auditimit që të mos dalë si e gjetur, sepse ne nuk jemi ata të cilët i ekzekutojmë këto lëndë. Për këtë arsye është marrë vendim që për të gjitha komunat të jetë si e gjetur dhe kjo mbetet pjesërisht e pazbatuar. Rekomandimi i dytë ka të bëjë me keklasifikimin e shpenzimeve. Edhe kjo është pjesërisht e zbatuar, pasi që kemi pasur raste ku Thesari ka ekzekutuar shumë lëndë me vendime të gjykatave ose përmbarimore dhe mjetet financiare i kanë marrë aty ku ka pasur mjete, dhe normalisht ka dalë si keklasifikim në kategorinë e shpenzimeve. Në vlerësimin e regjistrit të pasurisë së pasqyrave vjetore financiare është e gjetur plotësisht e zbatuar, si dhe të arkëtueshmet. Edhe kjo është pjesërisht e zbatuar, pasi që ne kemi ushtruar kontrollin tonë në inkasimin e të hyrave, kemi bërë njoftime të ndryshme për afatet e pagesave, kemi ofruar marrëveshje për pagesa me këste të obligimeve, por normalisht nuk është zbatuar plotësisht kjo e gjetur, pasi që shumë tatimpagues kanë ndryshuar vendbanimet e tyre dhe nuk kemi ndonjë adresë të saktë të tyre. Sa i përket të arkëtueshmeve që vijnë nga taksa e ushtrimit të veprimtarisë së bizneseve, janë shumë biznese që nuk e ushtrojnë veprimtarinë e tyre, por nuk janë të çregjistruara si biznese, andaj borxhi i tyre mbetet si i arkëtueshëm. Çështja e mos themelimit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm: nuk kemi mundur me planifikuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm, për shkak se nuk kemi pasur pozita të lira për të planifikuar staf të ri.

Sead Vila thekson: ishin diku pesë komponenta të cilët janë rekomanduar për me u përmirësuar, por janë për pasqyrat financiare të vitit 2024, por nuk po më duket e arsyeshme që gjithmonë me adresuar fajin te kodi buxhetor, te gjykatat, përmbaruesit, kur e dimë që Ministria e Financave ua ka lejuar komunave që të ndajnë buxhet për obligimet të cilat rrjedhin nga kontrata kolektive dhe komuna jonë nuk e ka planifikuar një gjë të tillë. Nëse jo në këtë vit, do të ishte mirë që me buxhetin e vitit 2027, sepse edhe në të ardhmen ka me pasur kërkesa për mjetet që derivohen nga kontrata kolektive, për obligime të tjera që rrjedhin me gjykatë, dhe kjo është më shumë faj i drejtorisë që nuk e ka marrë këtë rekomandim për me ndarë buxhet, sepse e din pak a shumë një shumë orientuese se sa ka obligime ndaj mësimit dhe shërbimeve. Ne e dimë që çdo komunë duhet me pasur auditorë të brendshëm dhe, në bazë të buxhetit të cilin e kemi, duhet të jenë dy zyrtarë dhe Ministria thotë që duhet të ketë zyrtarë të auditimit, e ju arsyetoni se nuk kemi pozita të lira për me shtuar numrin. A ka mundësi që ndonjë pozitë tjetër, e cila është ndoshta më sekondare, dhe mos me hapë ndoshta pozita të tjera, e me u paraqitur si prioritet e me u plotësua kjo? Shqetësimi im është adresimi që faji zhvendoset diku tjetër.

Lindita Ballazhi thekson: Unë nuk pajtohem me ato të cilat i potencuat ju, sepse nga Ministria e Financave nuk na është lejuar me planifikuar ndonjë kategori buxhetore sa i përket kontratës kolektive dhe deri tash nuk kemi pasur asnjë informacion dhe asnjë udhëzim, as nga analistja buxhetore, as nga udhëheqësit e divizioneve apo nga drejtori i departamentit. Po të ishte ashtu, edhe për ne do të ishte më e lehtë, pasi që gjatë vitit fiskal kemi pasur shumë procedura në realizim e në përfundim e sipër dhe, pa pritmas, thesari i ka ekzekutuar lëndët të cilat kanë ardhur me përmbarim. Me ç'rast ne është dashur të bëjmë zgjidhje për me t'i gjetur ato mjete financiare, në mënyrë që të ekzekutohen ato obligime rrjedhëse të cilat kanë qenë. Po që se do ta kishim pasur atë kod ekonomik për kontratën kolektive, më e lehtë do të ishte edhe për ne, por vendimet me përmbarim nuk janë ekzekutuar nga ne, por drejtpërdrejt nga thesari dhe aty ka pasur mjete, ata i kanë marrë mjetet financiare. Në Ministrinë e Financave kemi bërë shumë kërkesa për t'u na aprovuar pozita të reja në komunë, por edhe më herët potencova se kemi mungesë shumë të stafit, për shkak se ne i plotësojmë kriteret dhe çdo organizatë buxhetore që ka mbi tre milionë euro e ka të drejtën me pasur një auditor të brendshëm, por në momentin që ke një numër të konsiderueshëm të stafit mundesh me bërë planifikim, por ne kemi zënë tavanin dhe nuk mundemi me bërë ndonjë planifikim dhe asnjë pozitë nuk është sekondare, por secila pozitë e ka rolin e vet dhe përgjegjësitë e veta në bazë të ligjit dhe rregulloreve në fuqi dhe, sikur atë pozitë ta kishim bërë sekondare, nuk mundemi, sepse auditori e ka koeficientin veçmas dhe nuk mundemi me ndonjë koeficient të ndonjë zyrtari tjetër në komunë.

Visar Hasallari thekson: Komuna e Hanit të Elezit e ka kaluar buxhetin mbi tre milionë euro dhe ky është kriter kryesor i Zyrës Kombëtare të Auditimit që komuna duhet me pasur auditor të brendshëm. Në të kaluarën, si organizatë, i kemi monitoruar kuvendet dhe në kuvend është diskutuar që duhet me pasur auditor të brendshëm, por e shoh që keni bërë përpjekje dhe keni bërë kërkesa në Ministrinë e Financave, mirëpo do të ishte mirë se sa kërkesa i keni bërë, veçanërisht për Zyrën Kombëtare të Auditimit, dhe për mbledhjen e radhës me na i sjell.

Lindita Ballazhi thekson: Obligative nuk është, por e plotëson kriterin për me pasur një auditor dhe ne i kemi bërë kërkesat tona për shtim të stafit.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

4. Informatë për ndarjen e bursave

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës, hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson: Në bazë të legjislacionit dhe rregulloreve të cilat janë në fuqi, drejtorja ka bërë thirrje për ndarjen e bursave. Pas thirrjes është formuar komisioni për ndarjen e bursave dhe pastaj është publikuar lista. Gjithsej kanë aplikuar 68 studentë dhe përfitues kanë qenë 51. Përveç materialit, diçka të veçantë nuk kam.

Resul Suma thekson: Sa i përket bursave për studentët e Maqedonisë së Veriut, të parapara me rregullore, e kemi pasur që minimum me qenë dhjetë bursa dhe, në rast që nuk mbushet numri me studentët të cilët i plotësojnë kushtet prej Universitetit të Prishtinës, me shtuar numrin e studentëve të cilët i plotësojnë kriteret prej UP-së dhe nga dhjetë kandidatët që kanë qenë prej Universitetit të Tetovës kanë fituar vetëm gjashtë.

Sherif Bushi thekson: Listën e përfituesve të bursës e pashë që është plotësuar edhe me studentë të vitit të parë, por me çfarë kriteri kanë përfitur këta studentë, sepse gjashtë prej tyre kishin mbetur jashtë listës.

Medina Imishti thekson: Pas mbledhjes së KPF-së e kam shqyrtuar rregulloren për ndarjen e bursave. Sinqerisht, po më vjen keq që ish-kuvendi e kanë votuar propozim-ndryshimin e kësaj rregulloreje, ku kompetencat e kuvendit ia kanë kaluar kryetarit të komunës dhe çdokush që e ka votuar atë ia ka ulur vlerat këtij kuvendi. Po më vjen keq për z. Resul Suma, i cili sot po bën pyetje sikur po don me i mbrojtur studentët, por z. Resul Suma ka qenë njëri prej votuesve që, do të thotë, kompetencën që Ligji për Vetëqeverisje Lokale ia ka dhënë Kuvendit të Komunës, kuvendi ia ka kaluar kryetarit, që i bie se për çdo vit mundet me caktohet numrin varësisht se si janë në renditje dhe, nëse është dikush i 52-ti, i jep 51 bursa. Kështu që është rritur numri i përfituesve të bursave, por me gjithë atë, ajo që po më intereson me ditë është se a është menduar ndonjëherë me rritur vlerën e subvencionimit të bursave, sepse të gjithë e dimë se si po ndërrojnë çmimet nga viti në vit dhe inflacioni, dhe a është menduar që bursat me u ngritur nga pesëqind në tetëqind euro.

Hisni Luri thekson: Sa i përket studentëve të Maqedonisë Veriore, tash nuk ka dallim dhe, nëse i kalojnë kriteret e rregullores, do të jenë të përfshirë dhe, po qe se do të ishin edhe më shumë se dhjetë, do t'u jepet bursa. Sa i përket gjashtë studentëve të vitit të parë të cilët kanë mbetur jashtë, rregullorja e përcakton se duhet të merren për bazë notat e shkollimit të mesëm, fakultetet deficitare. Kryetari nuk e ka ndryshuar këtë pjesë, por me një vendim të Kryetarit të Komunës mundemi me rritur numrin e bursave dhe, fatmirësisht, numri i bursave vetëm po rritet e nuk po zvogëlohet. Nëse me një vendim të kryetarit ishin zvogëluar, atëherë kishim pasur telashe, por ne po i rrisim. Sa i përket rritjes së vlerës, tash po e shihni që studimet gati janë bërë falas, sidomos në Kosovë.

Resul Suma thekson: Shumë faleminderit që po i mbron studentët, z. Medina Imishti, por unë i kam mbrojtur studentët edhe kur keni qenë në atë karrigen përballë dhe ai kolegu mbrapa që keni potencuar që studentët e Maqedonisë i kanë kushtet e mira dhe nuk kanë nevojë për bursa. Fjalën e mora për shkak se katër apo pesë kolegë të mi, si mjekë të ardhshëm që sipas meje dhe rregullores së Universitetit Arsimor të Tetovës u ka takuar bursa, por komisioni së bashku me Drejtorinë e Arsimit ua kanë mohuar bursën, që unë mendoj që është e padrejtë. Ankesë kanë parashtruar dhe shumë shpresoj që ankesa do të jetë pozitive. Drejtor, ti së bashku me

komisionin keni gabuar që ua keni mohuar të drejtën e bursave atyre studentëve që i kanë plotësuar kriteret. Ju kam treguar juve edhe komisionit që në Universitetin Shtetëror të Tetovës nuk llogaritet “përsëritës” ajo që ju e keni quajtur përsëritës. E ritheksoj se nuk është puna vetëm te vlera materiale, por është te vlerësimi dhe diskriminimi që komuna ua bën mjekëve dhe doktorëve të ardhshme.

Hisni Luri thekson: Ka të drejtë secili me menduar ndryshe, por nuk është e vërtetë që jam përzier te komisioni. Drejtori i arsimit e ka parë listën sikur ti që e ke parë këtu dhe as nuk i dërgoi listat te kryetari, dhe nëse ka mundur të gabojë komisioni edhe ata janë njerëz.

Sherif Bushi thekson: Është mirë që herën tjetër t’i prezantoni edhe kriteret me të cilat janë vlerësuar, sepse vetëm numrin e pikëve e keni shënuar.

Medina Imishti thekson: Unë nuk të vlerësova në këtë pikë z. Resul Suma, por të kritikova. Për pjesën që ke arritur t’i sjellësh studentët e Maqedonisë e vlerësoj, por për pjesën që ty ta ka dhënë ligji dhe qytetarët ta kanë dhënë votën dhe ia jep një individ, unë për këtë pjesë të kritikova dhe për atë tash nuk dihet sa studentë marrin bursë sepse ka kaluar kompetenca diku tjetër. Unë e vlerësova që është rritur numri i bursave, por vetëm parashtrova pyetje se a do të rritet edhe vlera.

Resul Suma thekson: Është mirë që po më kritikoni kur gaboj, por është mirë me pranuar që edhe ju keni qenë në pozitën përballë dhe nuk e keni lejuar asnjë student nga Maqedonia e Veriut me marrë bursë. Njëjtë është se nëse unë paskam gabuar është gabimi im, por a keni gabuar ju që nuk i keni dhënë?

Menduh Vlasi thekson: Unë edhe sot e kësaj dite jam kundër dhe i kam arsyet e mia pse jam kundër, sepse nëse u jepet Universitetit të Tetovës duhet t’u jepet edhe studentëve të cilët studiojnë në Universitetin e Tiranës, Austrisë. Paraja publike shkon te institucioni publik, e jo te institucioni privat, sepse për ne është privat për shkak se paguajnë studentët. Kur e kemi pasur rregulloren në diskutim, një student i Universitetit të Tetovës insistonte dhe e pyeta se a mund të na tregosh pse nuk u regjistrove në Universitetin e Prishtinës, tha nuk munda ta jap provimin dhe pikërisht për këtë thash jam kundër. Kuvendi duhet të marrë vendim për numrin e bursave dhe sasinë e mjeteve financiare, kriteret, fakultetet prioritare, dhe ka qenë kështu deri në vitin 2024. Por në webfaqe e pashë që keni bërë ndryshim të rregullores dhe për mua kjo listë është e panevojshme të vijë, sepse nëse një organ merr vendim atij i raportohet. Ka marrë vendim kryetari, pse po e bëni këtë listë? Bëj apel te kryesuesi, merre iniciativë dhe ktheja këtë kompetencë, sepse është kompetencë që nuk delegohet, lexoni nenin dyzet të ligjit për vetëqeverisje lokale. Kuvendi duhet të vendosë sa bursa, cilit universitet, dhe kriteret, e jo kryetari, sepse një njeri mund të gabojë, e jo pesëmbëdhjetë. Nëse nuk i kthehet kjo kompetencë, mos e sillni këtë pikë, as që më vyen.

Resul Suma thekson: Qasja e juve përjashtuese qoftë e studentëve të Universitetit të Tetovës, qoftë e atyre që janë ankuar, ju ka sjellë këtu ku jeni në karriget këtu mbrapa. Nuk është problem, ti mundesh me menduar që Universiteti i Tetovës është privat, unë të garantoj që është i shtetit, e ty nëse e garanton diku që është privat, unë dal dhe kërktoj falje publike, sepse është e tepërt ajo që je duke e thënë.

Hisni Luri thekson: Faleminderit z. Menduh Vlasi, ish drejtor i arsimit, se në momentin që e ke përfunduar mandatin nuk je bërë i gjallë, sepse ne kemi kërkuar njerëz të dijshtëm me kaq përvojë që e ke pasur me qenë pjesë e asaj rregulloreje që mos me na lënë me gabuar, por ne nuk kemi gabuar. Propozimet i kemi dhënë që t’i përfshijmë edhe shtetet e tjera ku studiojnë studentët tanë, si p.sh. në Universitetin Publik në Shkup “Nëna Terezë”, por nuk kanë kaluar këto propozime. Rregulloren e kemi trashëguar prej jush me gjithë ato pika që janë në rregullore, por nuk janë publike, dhe nëse doni me qenë publike duhet të bëni kërkesë për qasje në dokumente zyrtare që t’i shfletoni të gjitha. Më herët është kërkuar që lista të bëhet sa më e qartë, sepse ka qenë e tepërt ajo mënyrë. Përndryshe komisioni vlerëson në ato pikë dhe kriteret që janë në rregullore. Kur ndahen subvencionet i ndajmë bashkë në Kuvend, sepse i kemi planifikuar mjetet, sepse shumica e subvencioneve shkon për studentë. Te rregullorja është ndryshuar një kriter që kryetari, sa ka mjete, aq t’ua ndajë studentëve.

Menduh Vlashi thekson: Kur e kam lexuar listën seriozisht jam gëzuar, sepse kemi studentë të mirë me nëntëshe e dhjetëshe, por ti ma ke sjellë një listë që nuk e kam ditur se çka është bërë dhe ti potencove që bashkë, por ju i keni ndarë dhe neve vetëm na e keni sjellë listën që këtyre ua kemi dhënë. Unë potencova që për mua mos e sill hiq, për arsye se ne nuk jemi kompetentë për me analizuar, sepse nuk kemi marrë vendim, por kryetari ka marrë vendim për numrin dhe për sasinë e mjeteve financiare.

Visar Hasallari thekson: Te çështja e kolegut z. Menduh Vlashi unë nuk pajtohem, ashtu siç nuk jam pajtuar edhe në të kaluarën. Te çështja e studentëve të Tetovës unë nuk jam pajtuar edhe kur ka qenë drejtor i arsimit, me të cilin kemi diskutuar, dhe arsyeja që na është dhënë nga ekzekutivi i kaluar kur kemi bërë thirrje që të mbështeten studentët e Universitetit të Tetovës ka qenë se nuk ka mundësi ligjore dhe nuk ka financa. Ne jemi mundur ta bindim në atë kohë ekzekutivin me fakte dhe argumente që Ministria e Arsimit ia delegon kompetencat Kuvendit Komunal, dhe këtu nuk pajtohem me z. Menduh Vlashi. Unë pajtohem me z. Menduh Vlashi te pika e ndryshimit të rregullores, e përshëndes vendimin dhe falënderoj legjislativin e kaluar që e ka ndryshuar atë rregullore, por është mirë me pasë të qartë të gjithë asamblistët, sepse ka ndodhur edhe një plotësim ndryshim brenda asaj rregulloreje dhe janë ndryshuar dy pika, dhe komisioni është rritur nga tre në pesë anëtarë, dhe veçanërisht duhet të diskutohet që subvencionet për arsimin, kategoritë dhe shuma për bursa do të përcaktohen me vendim të kryetarit të komunës, dhe çdo vit fiskal si shuma të tjera dhe vendime të veçanta të kryetarit të komunës. Në parim e mbështes që janë futur edhe studentët e Tetovës, por për këtë rregullore, për këtë pikë, unë propozoj që në mbledhjen e ardhshme ta bëjmë ndryshimin e kësaj rregulloreje te çështja e pagesës dhe e çmimit për mbështetjen e bursave, sepse nuk është ndryshuar prej se mbaj mend kur jemi komunë, çmimet dhe inflacioni janë rritur.

Kryesuesi thekson: Dëshira është e madhe, por mundësitë janë të kufizuara. Studentët të cilët janë në Tetovë, po të kishin mundësi do të regjistroheshin në Universitetin e Prishtinës, nuk kishin shkuar atje, por kanë bërë zgjidhje atje dhe është universitet shtetëror, dhe tarifat të cilat i vendosin për shtetas të huaj nuk kemi faj ne dhe nuk duhet të jemi kundër asnjëherë, për shkak se janë fëmijët tanë. Çdo send që bëhet mirë për studentë dhe për çdo komunitet është mirë për të mirën e të gjithëve. Unë nuk mundem me u pajtuar me u bërë disa punë me tendenca, këto nuk na falen jo pushtetit por edhe opozitës, sepse çdo send që është për të mirën e këtij vendi duhet ta përkrahim siç e kemi përkrahur vazhdimisht. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës sipas agjendës.

5. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2026 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin, nëse nuk ka, kalojmë në pikën e radhës sipas agjendës.

6. Bartja e bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson: Të hyrat e realizuara për vitin 2025 janë në shumë prej 1,268,412.73 €, prej tyre janë shpenzuar 707,343.26 €, kurse për bartje kanë mbetur 561,069.47 €. Bilanci i pashpenzuar i vitit 2024 i cili është bartur në vitin 2025 ishte në shumë prej 170,771.67 €, prej kësaj shume u shpenzuan 151,656.91 €, kurse për bartje kanë mbetur 19,114.76 €. Pra në total të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit 2025 janë në shumë prej 580,184.23 €, të cilat i bartim në vitin 2026. Bartja do të realizohet në kategori buxhetore dhe nën-programe buxhetore. Në material i keni të sqaruara në cilat kategori dhe nën-programe buxhetore do të barten mjetet financiare.

Sherif Bushi thekson: Shuma e pashpenzuar e të hyrave vetanake për vitin 2025 ishte mbi 44%, ndërsa duke e shtuar edhe shumën e vitit 2024 të cilat janë bartur për vitin 2025 dhe të cilat nuk janë shpenzuar, përqindja e pashpenzuar rritet. Ku është problemi i kësaj çështjeje: a në mosplanifikim të buxhetit apo mos menaxhim i mirë i buxhetit. Bartja e tyre që i keni cekur në kategori buxhetore e keni potencuar se ku keni me i bartur, por edhe jo se çka do të punohet konkretisht me to.

Medina Imishti thekson: Meqë te rendi i ditës më bë një padrejtësi, se propozimi im nuk doli në votim dhe te kjo pikë dua me qitë në votim propozimin tim. Meqë komuna e Hanit të Elezit është ndër komunat e para në Kosovë që i ka subvencionuar lindjet dhe ka qenë shembull për të gjitha komunat në Kosovë të cilat e kanë marrë si praktikë të mirë, propozoj që te kategoria e subvencioneve të shtohet edhe një shumë prej 25.000 € dhe kërkoj që subvencionimi i lindjeve të rritet nga 100 € në 300 €. Mendoj që gratë dhe nënat kanë nevojë për përkrahje.

Sead Vila thekson: Në kategorinë buxhetore shpenzime kapitale te pika dy, parandalimi dhe inspektimi i zjarrit, a e ngërthen në vetvete edhe ndriçimin publik, që po shihet që është vazhdimësi e kësaj të parës, sepse po shihet që janë dy kode buxhetore: 100.000 € parandalimi dhe inspektimi i zjarrit, por nëse është veçmas çka është menduar konkretisht. Te kategoria planifikimi urban dhe inspeksioni, pika e fundit, rregullimi i rrugës nga Burimi deri në Lepencë në shumë prej 35.000 €, kërkoj sqarim se çka është menduar konkretisht.

Lindita Ballazhi thekson: Ne kemi pasur një tejkalim të projeksionit të të hyrave vetanake vitin e kaluar, ku të hyrat janë rritur shumë në krahasim me projeksionin fillestar dhe janë shpenzuar aq sa është punuar dhe mjetet të cilat nuk janë shpenzuar do të barten në këtë vit dhe në ato kategori buxhetore që do të barten mjetet, çdo drejtor e ka planin e vet se çka do të bëhet me këto mjete financiare. Mirëpo pjesa më e madhe e këtyre mjeteve ka të bëjë me disa punë në projektet kapitale që punimet nuk kanë arritur të përfundohen gjatë vitit 2025, në të cilat nuk janë kryer punimet dhe pagesat nuk mund të bëhen, por tash janë finalizuar dhe për ato projekte pagesat do të kryhen pasi të barten mjetet financiare. Sa i përket propozimit për subvencionimin e lindjeve, ky propozim nuk mund të ipet tash, por ky propozim duhet të ipet në fazat e planifikimit të buxhetit për vitin 2027. Te projekti parandalimi dhe inspektimi i zjarreve, e keni drejtorin e shërbimeve publike dhe saktësisht mund t'ju japë shpjegime se çka do të punohet në atë projekt. Te planifikimi urban dhe inspeksioni, shumica e projekteve nuk kanë arritur të finalizohen 2025, por edhe obligimet duhet të shlyhen tash ku janë përfunduar ato punime dhe saktësisht i kemi edhe faturat se sa obligime i kemi ndaj operatorëve ekonomikë të cilët i kanë implementuar ato projekte.

Medina Imishti thekson: Unë nuk e di pse nuk kam të drejtë për me propozuar që me u rritur vlera e subvencioneve, e ju keni të drejtë me shtijë një projekt të ri në listën e projekteve kapitale.

Basri Dernjani thekson: E kam analizuar këtë shpërndarje dhe duke i parë projeksionet edhe unë kam qenë i interesuar që me u rritur pagesa për lehonat, por në bazë të raportit të cilin e kemi, në këtë rast nuk na lejon, për shkak se ne mundemi me votuar diçka, por në fund të vitit ndoshta nuk mundemi me i realizuar projektet të cilat i kemi paraparë.

Medina Imishti thekson: Te bartja e mjeteve është projekti i ri në shumë prej 50.000 € për blerjen e veturës së re dhe nëse kalon kjo pikë, se po besoj që kalon që i keni votat, mirëpo pika e shtatë nuk kalon, a i bie që ka hyrë si projekt apo nuk ka hyrë.

Lindita Ballazhi thekson: Ligji i buxhetit e lejon që të futen projekte të reja në listën e projekteve kapitale, përderisa financimi të jetë plotësisht prej komunës. Ne e kemi pasur edhe vitin e kaluar të njëjtin rast, kemi shtijë në listë të projekteve ndërtimin e parkingut në afërsi të xhamisë në fshatin Paldenicë dhe në Kuvend është votuar financimi, dhe pastaj projekti si kod ekonomik i ri në listën e projekteve kapitale. Kur të bartet bilanci i pashpenzuar, e kemi edhe kërkesën tjetër për t'u futur në listë të projekteve edhe ai kod i projektit. Nga Ministria kemi rekomandim që së pari duhet të sigurohet financimi, pastaj të votohet edhe projekti i ri.

Menduh Vlashi thekson: Rregullimi i rrugës “Ekzodi 99” kërkoj sqarim saktë se ku është ajo rrugë. Rregullimi i infrastrukturës shkollore në shkollën e mesme “Dardania” dhe “Ilaz Thaçi”, kërkoj sqarim se çka do të punohet. Parimisht jam për me miratuar këtë pikë të rendit të punës, por jam edhe kundër automjetit, sepse ndoshta unë jam kundër automjetit, por për gjërat tjera jam pro, e tash detyrona me qenë kundër për krejt që nuk është e vërtetë që jam kundër për krejt. Nuk qëndron ajo që potencuat që mund të bëhet më vonë, sepse edhe vetura ka mundur me mbetur për më vonë, por kur kemi mundësi me fut një projekt të ri edhe çështja e lehonave është një lloj projekti. Vetura që do të blihet, a do të regjistrohet me tabela zyrtare apo civile, sepse është një dukuri në tërë Kosovën se zyrtarët e lartë më shumë i regjistrojnë veturat me regjistrim civil. Edhe më herët ka ndodhur, por jo kaq në masë. Vetura zyrtare e komunës është parë para shkollës ekonomike ditën e diel në Ferizaj.

Lindita Ballazhi thekson: Rekomandimet i kam marrë prej analistes së buxhetit të Ministrisë së Financave, sepse fillimisht duhet me siguruar financimin e atij projekti. Qeveria nuk na ndihmon në financimin e blerjes së automjetit dhe nëse dëshirojmë tash me futë ndonjë projekt të ri, financimi duhet të jetë prej komunës.

Nexhmedin Daci thekson: Rruga e Ekzodit 99 është asfaltimi deri te monumenti atje. Emërtimi është në rregull, sepse në këtë formë është miratuar në Kuvend. Është rregullimi i rrugës prej te Burimi deri në Lepencë është kod nga viti i kaluar dhe bëhet fjalë te shtëpia e z. Fari Shkreta, është rrugë të cilën e kanë shfrytëzuar fshatarët dhe bie deri në Lepencë.

Senad Kalisi thekson: Kodi për parandalimi dhe inspektimi i zjarreve ka të bëjë me ndriçimin publik për ndarjen e ormanëve dhe ndërrimin e dritave.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte 9 për, 6 kundër.

U MIRATUA BARTJA E BILANCIT TË PASHPENZUAR NGA VITI 2025 NË VITIN 2026

7. Kërkesë për futjen e projektit të ri “Blerja e një automjeti zyrtar” në kuadër të buxhetit për vitin fiskal 2026.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson: Materialin e keni para vetes dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Visar Hasallari thekson: Fillimisht dua të shpreh një shqetësim për këtë kërkesë për blerjen e automjetit zyrtar. Në kohën kur qytetarët tanë po përballen me sfida të ndryshme dhe duke parë shumë nevoja prioritare në komunën tonë, mendoj që duhet të jemi shumë të kujdesshëm me mënyrën se si e menaxhojmë buxhetin publik. Nga materiali të cilin na e keni përcjellë, kjo kërkesë arsyetohet me faktin se automjeti ekzistues ka filluar të amortizohet, por kjo sipas mendimit tim nuk është një arsyetim i mjaftueshëm për të kaluar menjëherë në blerjen e automjetit të ri. Prandaj kam disa dilema serioze në këtë pikë: a është bërë vlerësimi i detajuar teknik për blerjen e automjetit aktual, a janë shqyrtuar opsione më ekonomike si p.sh. mirëmbajtja dhe riparimi, dhe mbi të gjitha a është kjo një prioritet për komunën tonë, sepse nëse e shikojmë realitetin në terren kemi shumë fusha ku qytetarët presin investime më të drejtpërdrejta, qoftë në infrastrukturë, shërbime dhe në çështje sociale. Dua të theksoj një gjë shumë të rëndësishme: është e vërtetë që ne jemi pjesë e koalicionit qeverisës, por unë si përfaqësues i qytetarëve kam marrë votën për të qenë këtu për të dhënë ide dhe për të ngritur çështjet që kanë qëllim për mbrojtjen e interesit të qytetarëve, e jo për të mbështetur çdo vendim pa e analizuar. Prandaj çdo propozim që vihet para nesh duhet të vlerësohet mbi bazën e interesit publik dhe nevojat e qytetarëve. Prandaj mendoj se kjo kërkesë duhet të Rishqyrtohet deri sa të kemi një arsyetim më të fortë dhe një pasqyrë më të qartë në prioritetet tona si komunë, sepse çdo euro e buxhetit komunal është para e qytetarëve dhe, para se të shkojë për komoditet institucional, duhet të shkojë aty ku ka më shumë nevojë qytetari. Deri sa nuk e kemi një arsye bindëse si grup parlamentar, në këtë pikë do të votojmë kundër.

Sevdi Dernjani thekson: Besoj që e ke marrë materialin dhe nuk je duke e ditur se kujt je duke iu referuar, se cilit automjet zyrtar. Zyra e kryetarit i ka dy automjete, njëri është në gjendje, po thuajse të amortizuar qind për qind, dhe kjo ka shtyrë që të shkohet drejt një automjeti të ri. Shuma prej pesëdhjetë mijë euro nuk nënkupton që automjeti ka me qenë pesëdhjetë mijë euro, por janë të planifikuara dhe kur të dalë në procedura të prokurimit kjo mund të jetë deri në tridhjetë mijë euro, sepse ligji i prokurimit nuk e specifikon se me cilin operator duhet të drejtohem. Zyra e kryetarit i posedon dy automjete, njëri është pothuajse njëqind për qind i amortizuar dhe nuk është në gjendje të mirë funksionimi. Për këto arsye është marrë iniciativa nga kryetari për të pasur një automjet tjetër.

Visar Hasallari thekson: Në materialin që është përcjellë, na është dhënë vetëm një fakt, çështja e amortizimit, dhe si t'i besojmë ne dhe qytetari se nuk na i keni prurë një argument për të besuar. Unë po kërkoj një fakt apo argument, nuk jam në parim kundër që institucionet tona të kenë makina për shërbime më të mira, por na i keni përcjellë vetëm këtë fakt dhe si t'u arsyetohemi ne para qytetarëve.

Sevdi Dernjani thekson: Për ndonjë specifikacion për gjendjen e automjetit mund t'i drejtoheni zyrës së autoparkut dhe të merrni gjendjen faktike mbi bazën e gjendjes faktike të automjetit që e ka kryetari.

Visar Hasallari thekson: Unë nuk e njoh zyrën e autoparkut, por po i drejtohem zyrës së kryetarit që deri në mbledhjen e radhës të na sigurojë këto që po i kërkojmë, sepse përndryshe do të votojmë kundër.

Medina Imishti thekson: Potencuat që i kemi planifikuar pesëdhjetë mijë, por nuk e dimë sa kemi me ble, dhe kryetari nuk blen veturë pesë mijë euro, por ne i dimë çmimet e veturave.

Sevdi Dernjani thekson: Unë besoj që me atë shumë ka me u blerë një veturë relevante.

Basri Dernjani thekson: Unë mendoj që nëse ne jemi ligjrisht në rregull nuk kemi pse me diskutuar, sepse komuna e ka paraparë se amortizimi i veturave ekzistuese është jashtë normales dhe nuk besoj që neve duhet me na preokupuar ai mendim që ndoshta vetëm për luks jemi duke menduar, duke e ditur që, siç potencoi edhe z. Menduh Vlashi, është mirë që edhe veturat zyrtare të regjistrohen me targa zyrtare, sepse nevojat janë të kryetarit, nënkryetarit dhe të komunës. Kërkoj që të kemi një pauzë prej pesë minutash.

Visar Hasallari thekson: Unë nuk jam kundër, por unë nuk e votoj përderisa nuk e kemi një dëshmi apo një fakt; këtë të cilën na i keni përcjellë nuk më bind për të votuar pro.

Kryesuesi thekson: Pasi që z. Basri Dernjani kërkoi pauzë, atëherë dhjetë minuta pauzë. Pas pauzës të cilën e patëm, a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 8 për, 7 kundër.

U MIRATUA KËRKESA PËR FUTJEN E PROJEKTUT TË RI BLERJA E NJË AUTOMJETI ZYRTARË NË KUADËR TË BUXHETIT PËR VITIN FISKAL 2026

8. Të ndryshme

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin.

Shefket Lusnjani thekson: Kërkesa për shtrimin e rrugës me kubëza betoni në fshatin Rezhanc është bërë; a do të bëhet në këtë vit apo jo? Drejtorin e shërbimeve publike e falënderoj për punët e rrugës që është bërë për te pllaka e dëshmorit Feriz Guri, mirëpo unë kam kërkesë që të bëhet një rrugë alternative, që të rregullohet një herë e përgjithmonë. Për drejtorin e shëndetësisë kam ankesa nga banorët për çështjen e analizave të gjakut, për shkak se disa analiza bëhen këtu e disa duhet të bëhen privat. Kur do të fillojnë punimet e rrugës Gorancë-Krivenik? Parku që është duke u rregulluar, a keni dalë në terren për të vizituar se çfarë pune është duke bërë ajo kompani? Por po ashtu ka keqpërdorime, për shkak se po ndezin zjarre për të pjekur flija, qytetarë të ndryshëm, po ashtu edhe mbeturina po hedhin.

Sevdi Dernjani thekson: Sa i përket çështjes së analizave, drejtoresha e shëndetësisë më ka njoftuar se për shkak të procedurave të prokurimit ende nuk mund të bëhen analizat. Rruga Gorancë–Krivenik ka përfunduar procedura, por ka mbetur të nënshkruhet kontrata, por për shkak të mungesës së shefit të prokurimit nuk ka mundur të realizohet, me pretekstin se shefi i prokurimit është në regjim shtrati dhe nuk do të jetë për një kohë të gjatë. Sa i përket parkut në Gorancë, edhe ju edhe unë bëjmë ftesë për vetëdijesim që mos ta keqpërdorin atë park. Sa i përket kualitetit, është kontrata me garancion edhe për keqpunim të ndërtimeve që i bëjnë; në fund është komisioni që del në vendngjarje dhe e bën vlerësimin e atij projekti dhe pranimin teknik.

Shefket Lusnjani thekson: Derisa do të shkojë kjo puna e prokurimit, derisa do të presim për këto mungesa, a nuk ka zëvendësim, sepse gjysma e vitit ka shkuar.

Nexhmedin Daci thekson: Rruga për te varrezat për vitin e kaluar janë ndarë 25,000 €, por me alokim të mjeteve projekti do të kryhet në këtë vit. Sa i përket projekteve të tjera, nuk kemi mundur t'i kryejmë për shkak se alokimi i buxhetit është bërë me vonesë dhe tash është muaji prill, dhe ne në këtë muaj jemi duke marrë vendim që mjetet financiare të vitit të kaluar t'i shpenzojmë. Nuk është që ne nuk po duam, por ka kufizime ligjore, sepse nuk mund të shpallet tender nëse nuk ke mjete financiare. Punimet te parku nuk kanë përfunduar dhe gabimet korrigjohen.

Medina Imishti thekson: Si grup parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, është mbledhja e katërt e kuvendit dhe e kemi dëshmuar që jemi bashkëpunues, por edhe kritikues aty ku mendojmë se ka vend për kritikë. Propozimi të cilin e propozova nuk doli në votim.

Kryesuesi thekson: Nuk ka qenë pikë për të propozuar, por ti mund ta propozoje te “të ndryshmet”.

Medina Imishti thekson: Tash nuk mundem sepse ajo pikë ka kaluar, por bashkërisht u dakorduam që këtë propozim ta japim në një moment tjetër, mirëpo nuk është në rregull, sepse kur diçka propozohet duhet të dalë në votim dhe nëse vetëm vota ime është për, ne të jetë vetëm ajo. Drejtoresha e financave ka shkuar, por e falënderoj për korrektësinë dhe bashkëpunimin, për shkak se në mbledhje të KPF-së kam kërkuar të di disa shpenzime të një kodi që kanë qenë shpenzimet e përfaqësimit brenda vendit, dhe drejtoresha i kishte përcjellë të gjitha, por pa shuma, vetëm me aktivitete që janë realizuar. Të njëjtën e kërkova edhe sot që drejtoresha të ma përcjellë me shkrim. Çdo herë kur diskutohet për buxhetin diskutohet në vlera, kështu që përveç aktiviteteve që janë realizuar kërkoj të më përcillen edhe vlerat sa kanë kushtuar. Në sektorin e shëndetësisë po më intereson të di sa pozita të lira janë aktualisht. A janë të përcaktuara profilet, nëse janë, a i ka përcaktuar ministria apo varësisht prej kërkesës që e ka përcjellë drejtorja? Kam parë që janë shpallur disa konkurse dhe pse disa janë shpallur me shkollë të mesme e disa me bachelor? Pse nuk ka konkurs për shofer dhe a do të ketë konkurs për shofer?

Sherif Bushi thekson: Kërkesë kam nga banorët të cilët banojnë në lagjen Elham Curri, shtëpitë të cilat janë shpronësuar por paraqesin rrezik për banorët, sidomos për fëmijët. Rrezikohen që të shemben, por ato shtëpi janë bërë strehë edhe për qentë endacakë. Ndriçimi publik i cili e lidh qytetin me Lagjen Uji i Thartë në shumicën e rasteve po është jashtë funksionit dhe janë disa shtylla elektrike të cilat janë të dëmtuara tërësisht. Bëj apel që t'i kushtohet vëmendje asaj pjese, sepse përveç banorëve të asaj lagjeje, atë trotuar e shfrytëzojnë edhe qytetarët e Hanit të Elezit.

Senad Kalisi thekson: e kam për sysh që janë ato dy shtylla, por gjatë punimeve të cilat janë bërë nga hekurudha, kompania i ka dëmtuar edhe ato dy shtylla, por edhe pjesë të trotuareve deri te Uji i Thartë. Ne i kemi bërë një shkresë Ministrisë dhe kanë dalë në vendngjarje, por pas përfundimit të punimeve që janë duke i bërë te pjesa e hekurudhës, ajo kompani detyrohet me kryer atë pjesë që e ka dëmtuar.

Nexhmedin Daci thekson: çështja e shpronësimit të shtëpive në Lagjen Elham Curri, projekti ka qenë i Ministrisë së Infrastrukturës, duhet t'i drejtohen komunës dhe pastaj komuna i dërgon shkresë Ministrisë së Infrastrukturës.

Sead Vila thekson: kërkoj nga drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport që të shkojë dhe ta vizitojë sallën sportive të shkollës fillore "Ilaz Thaçi", sepse përveç që janë të demoluara ulëset, po që se hyhet nëpër tualete, komplet janë të shkatërruara pajisjet banale dhe pjesët përcjellëse. Pastërtia është në nivele shumë të ulëta dhe kërkoj që të merren masa urgjente.

Menduh Vlasi thekson: kërkoj nga zyra e Kryetarit të Komunës që për mbledhjen e radhës të na përcjellë vlerësimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal për çështjen e rregullores. Gjithçka që ndodh në Han të Elezit është punë e Kuvendit. Këtë të cilën do ta potencoj sot, mos më thoni që nuk e kam potencuar më përpara, sepse këto fjalë që do t'i them tash i kam thënë në vitin 2003 apo 2004, kur kam qenë drejtor shkolle, por edhe kur kam qenë drejtor i arsimit dhe nënkryetar i komunës. Kam potencuar në mbledhje të këshillit të arsimtarëve se ne po bëjmë krim dhe kjo bindje shkon vetëm duke mu shtuar, dhe atëherë më janë hidhëruar plot kolegë, sepse është fjalë e rëndë, por nuk është krim me vra me revole apo me pushkë, mirëpo krim më i rëndë se me lënë pa mësim dhe edukim fëmijën për mua nuk ka, për arsye se tërë jetën mbetet keq. Të përjashtohen dhjetë për qind e nxënësve të shkollës, a e dinë se çka do të thotë? Mos me ngritur zërin, sepse përjashtime janë bërë për çdo vit, por 10 % jo. Dhjetë për qind në Prishtinë i bien që me u pas përjashtuar njëqind e pesëdhjetë nxënës dhe ishte alarmuar e tërë Kosova, ndërsa te na thuhet hajt se nuk është asgjë dhe drejtori potencon se njëzet e nëntë, por unë jam i bindur që ka më shumë, por nuk na e sjellin informatën. Unë kërkova informacion të saktë, emrin, mbiemrin, kërkova se në cilën klasë, kërkova se me çfarë sukcesi ka ardhur në gjimnaz, a kanë qenë të dobët apo janë bërë në shkollë të mesme. Për mua personalisht ka qenë brengosëse, ndërsa këtu aq shumë u relativizua dhe u thjeshtëzua. Drejtori i arsimit potencon se të gjithë janë përjashtuar sipas rregullores, po ashtu edhe Kryetari i Komunës i cili ka qenë punëtor i arsimit një kohë të gjatë dhe potencon që nuk janë përjashtuar por janë suspenduar, i kërkova të gjitha ligjet e arsimit dhe nuk shënon që janë përjashtuar, por largim i përkohshëm, pavarësisht a suspendim, pavarësisht a largim, por në rregullore shënon përjashtim. Nuk është duke më interesuar termi, por këta nxënës nuk janë më në bankat shkollore, ata i keni qitur në rrugë, nëpër kafe me bërë probleme, pra thjesht nuk jemi duke u interesuar për gjeneratat e ardhshme. Sipas meje arsyeja që ka ardhur deri te ky skandal e para është se në gjimnazin tonë pranojnë nxënës me notë edhe me dysh, që është e jashtëligjshme. Arsyeja e dytë është se është krijuar një farë klime apo bindjeje se hajt se po rri unë nëpër kafiteri, se në fund na japin me provime, sepse këtë ua thonë profesorët dhe drejtori. Ju thonë shkoni te shtëpia e mos na bëni zhurmë, se në fund hyni në provim. Shkolla a është shkollë e natës apo joformale, dhe bëhet joformale sepse shkojnë vetëm në provime dhe e marrin. Shkolla është për me mësuar, me edukuar, e jo me dhënë diploma apo dëftesa. Nuk punojnë as prindërit, dhe nuk po them që është fajtor profesori, as drejtori, as kryetari, por edhe ne jemi fajtorë, sepse kur kam potencuar krim kam potencuar se fatkeqësisht jam në krye të atij krimi.

Basri Dernjani thekson: atë fjalën "krim" edhe atëherë kur e ke pas potencuar në shkollë kam qenë kundër dhe sot po ta them prapë se jam kundër. Po më vjen keq se prej arsimit je larguar bajagi shumë herët, sepse ke qenë në pozita udhëheqëse, drejtor, nënkryetar, mirëpo duke i parë të gjitha kushtet, siç ka rënë niveli i arsimit në Kosovë, nuk mund të potencojmë se nuk është duke u punuar, por tash edhe shkolla si shkollë i ka disa rregullore të brendshme të cilat i ndëshkojnë nxënësit, dhe nëse ne e heqim ndëshkimin atëherë ku mbesim. Unë pajtohem që politikën arsimore duhet të ndryshohen dhe jam vetë ithtar i asaj, për shkak se i kemi disa drejtime që nuk përkrijnë askund, mirëpo ne duhet të mobilizohemi të gjithë bashkë dhe këto politika t'i ndryshojmë, pra të ndryshojmë edhe drejtimet të cilat janë në Han të Elezit. Mirëpo me dal me një fjalë e me potencuar "krim" nuk e besoj, sepse sot e patëm një raport dhe informatën e bursave, ku pashë që kishte mrekulli aty, studentë të cilët kanë dalë prej shkollave tona duke filluar prej shkollës fillore e deri në të mesmen. Prandaj fjalën "krim" edhe një herë të kisha thënë ta tërheqësh prej fjalorit, por thuaj se a duhet me u përmirësuar, po, plotësisht.

Sevdi Dernjani thekson: nuk pajtohem me atë që gjithmonë pretendoni se çdo situatë politike në vendin tonë ju e bëni sa më shumë politike, sa më shumë me e zmadhuar. Ne nuk jemi duke jetuar në një univers paralel, por këtu jemi, unë ty të njoh, ti mua më njeh, dhe në kohën kur kam qenë në shkollë të mesme ju keni qenë drejtor i arsimit, dhe nuk është situata që ka ndryshuar 100 %, që ju keni dalë në opozitë dhe atëherë keni qenë në pozitë e tash është keq, por është e njëjta situatë, mirëpo pozicioni yt ka ndryshuar. Këndvështrimi yt ndaj nxënësve në realitetin të cilin e keni përcjellë është po i njëjti. Normal që ju duhet me kuptuar se keni qenë drejtor, nënkryetar i komunës, keni bartur poste të rëndësishme z. Menduh Vlashi, por kurrikulat për shkollë nuk i vendosim ne, por i vendos Ministria e Arsimit, ne jemi menaxhues dhe zbatues të atyre politikave të cilat vijnë prej nivelit qendror. Ne kemi bërë stimulim, kemi përmirësuar infrastrukturën nëpër shkolla, i kemi stimuluar studentët, që do të thotë gjithmonë jemi kanë aty për ta, nuk nënkupton kjo që kurrikula që nuk funksionon në nivel shteti me na i gjuaj fajin në nivel lokal. Nëse ne nuk jemi duke kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës tek arsimtarët, atëherë pajtohem plotësisht, por çka po na thua ne me i ndëshkuar profesorët, por nuk ta lejon kurrikula, por kjo është diçka me të cilën jemi duke u përballur si shoqëri në nivel tërë vendit. Gjendja aktuale që jemi duke e pas është nivel vendi e nuk është e krijuar në Han të Elezit. Adresimet të cilat je duke i bërë me shumë komoditet, e që në të kaluarën nuk ke pasur forcë me i ndryshuar, nuk do të thotë që tash me i stërmadhuar. Unë edhe atë ditë në KPF të thash që nëse ke ndonjë plan konkret, nëse ke diçka të detajuar që na duhet me përmirësuar sa i përket këtyre situatave, hajde sjelle dhe ne po e zbatojmë nëse janë në përputhje me ligjin.

Menduh Vlashi thekson: u potencua që lista e bursave është krenari për me e pa, por zotëria nuk e paska analizuar hiç se kryesisht ata të cilët janë me nëntëshe dhe dhjetëshe e kanë kryer shkollën e mesme në Ferizaj. Jo vetëm sot por edhe ditë tjera e keni përmendur që po bëni politikë se jeni opozitë, por për çka kemi ardhur këtu, a vetëm me ngrit dorën? Juve ua ka dhënë votën qytetari, por mu më ka pru politika këtu dhe unë bëj politikë opozitare, ty të ka pru politika dhe ti bën politikë me bursa, me subvencione, me pranime të kushërinjve, dajave, motrave, bën politikë me emërimet e drejtorëve dhe bën politikë, nuk të them asgjë se e ke marrë pushtetin, por të njëjtën gjë e bëj edhe unë dhe është e drejta ime si anëtar i kuvendit që për çdo shqetësim të Hanit të Elezit me ngritur zërin.

Visar Hasallari thekson: pse ka dështuar të bëhet sot transmetimi i seancave të Kuvendit të Komunës. Për mënyrën e publikimit unë kam potencuar që duhet të përdoret edhe platforma sociale e Facebook-ut. Po përdoret platforma e webfaqes zyrtare dhe qytetarët nuk po kanë shumë qasje te faqja zyrtare, qoftë kur është bërë publikimi i rezultatit të bursave, qoftë kur është bërë thirrja e publikimit për subvencione për klubet sportive dhe OJQ-të. Nuk është shenjë e mirë, por duhet ta diskutoni me zyrtarin kompetent, sepse ende pa përfunduar mbledhja e kuvendit publikohet në faqen zyrtare dhe nuk besoj që është gjest i mirë.

Natyra Kalisi thekson: - sa i përket transmetimit të seancave, e kemi shpallur dy herë këtë procedurë. Procedura e parë nuk ka pasur asnjë tenderues dhe është anuluar, ndërsa procedura e dytë është në OSHP dhe ka ardhur vendimi i OSHP-së, por zyrtari i prokurimit është duke i ndjekur procedurat dhe më gjerësisht mundeni me ju drejtuar zyrtarit të prokurimit. Sot jemi vetëm me incizim dhe pastaj do ta publikojmë të gjithë materialin. Secila drejtori e cila ka kërkesa për me i publikuar i përcjellim te zyrtari për transparencë, i cili e ka për detyrë me i publikuar në webfaqen zyrtare dhe në webfaqen e komunës. Mirëpo, ndonjë herë qëllimi është që me vizituar më shumë edhe webfaqen e komunës, sepse webfaqja e re është funksionalizuar me datë 18.01.2026 dhe është shumë e përshtatshme për me i gjetur informacionet aty dhe për mos me ngarkuar Facebook-un. Ndoshta ka qenë edhe kërkesë e drejtorive. Sa i përket vërejtjes të cilën e dhatë, që është bërë njoftimi ende pa përfunduar seanca për me u publikuar, do ta shikojë këtë çështje.

Visar Hasallari thekson: - nëse keni informacion në këtë seancë, por nëse nuk keni, a mundeni me dhënë informacion se pse ka shkuar lënda e transmetimit në OSHP, sa ofertues ka pasur dhe për çfarë arsye ka shkuar lënda në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Sead Vila thekson: - nëse është mundësia edhe unë e kërkoj, jo në detaje, por disa informacione të ipen edhe përmes faqes së Facebook-ut e jo aq shumë me hyrë përmes asaj, se është shumë e komplikuar, për shkak se një shumicë dërmuese e kanë shumë problem me hyrë dhe me marrë informacionin. Shumë gjëra kanë mbetur në webfaqen e komunës të pa rifreskuara nga legjislatura e më hershme dhe është mirë me i rifreskuar. Sa i përket pjesës së arsimit, realisht nuk ka institucion që nuk ka probleme, por unë edhe në seancën e kaluar e kam diskutuar që ne mundemi me ngritur çështje për me diskutuar, mirëpo nuk më duket që është e mundshme që në këtë vend me zgjidhur problemin, përveç se me i ngritur si çështje. Në muajin e kaluar i kam propozuar drejtorit të arsimit se nëse është diçka që ka të bëjë me nxënës, për mu politika është dytësore apo tërësore për me krijuar një siguri për fëmijët tonë dhe me krijuar një siguri për fëmijët tonë, se sa unë me bërë kundërshtime ndaj një individi apo me krijuar urrejtje ndërpersonale. Unë jam që me i identifikuar këto probleme përmes një punëtorie apo tryeze.

Natyrja Kalisi thekson: - më herët, para se me u bërë update webfaqja e re, webfaqja e vjetër ka qenë më e komplikuar. ASHI-ja ka investuar gjatë vitit të kaluar që gjatë vitit 2026 me pasur një webfaqe të re dhe webfaqja e re është shumë e përdorshme dhe shumë e lehtë dhe nuk i ka bllokadat të cilat i ka pasur më herët. Sa i përket përditësimit të dhënave për anëtarët e kuvendit, nuk e di a i ka kërkuar dikush informacionet për me i publikuar, por për këtë do t'i shikojmë. Por edhe nëse keni diçka konkrete për me u publikuar, për shkak se në Facebook nuk mundem me u publikuar konkurset sepse është portali shtetëror se ku janë konkurset. Janë shpalljet publike të cilat janë brenda webfaqes zyrtare, nuk ka nevojë duplikim, por edhe qytetari duhet me pasur vetëdijesimin që me hyrë në webfaqe zyrtare. Jo për diçka tjetër, por aty janë informatat taman të sakta dhe zyrtare me protokoll dhe merr shumë kohë dokumenti i cili është i skanuar. Rrjetet sociale janë më shumë për promovim dhe për aktivitete të përditshme të Komunës së Hanit të Elezit.

Visar Hasallari thekson: - qytetari nuk e viziton webfaqen zyrtare vetëm kur ka ndonjë hall apo ndonjë kërkesë. Faqen zyrtare të komunës të gjithë e kemi like dhe për atë kam kërkuar që me i publikuar thirrjet për subvencione, për mbështetjen e klubeve rinore apo publikimin e listave. Në të kaluarën i keni publikuar edhe në Facebook dhe është mirë që hapësirat që kanë të bëjnë me sportin me i publikuar, po ashtu edhe drejtoria e bujqësisë me i publikuar listat.

Ibadete Kuka thekson: - kërkesë kemi prej banorëve për çështjen e ndriçimit publik deri kur përfundojnë procedurat. Te Parku "Billaca 99" e shoh shumë të arsyeshme që me qenë edhe një çezmë për pastrimin e duarve, për shkak se qytetarët po e shfrytëzojnë për me qëndruar pasdite.

Senad Kalsi thekson: - mjetet financiare janë të zotuar dhe në proces, por sa kohë do të bëhet nuk mundem me dhënë afat, por për çështje të ndriçimit publik nuk është vetëm Seçishta, por ka edhe fshatra të tjerë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 14:25.

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

